



V E N D I M
K.P.P. 858/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.12.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-84317-08-31-2018, me objekt “Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtimi i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUT”, me fond limit 56.125.510,83 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 08.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k.
Rruga “Kosovarëve”, Pll.TID, Shkalla 2, Ap.5, Tiranë

“4 A-M” sh.p.k.

Rruga “Artan Lenja”, Pll i 4 A-M, Kati I, Ap.A1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar i Traumës
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Subjekte të interesuar: “Inerti” sh.p.k.
Elbasan, Gramsh, L. Sporti.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,



Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.09.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-84317-08-31-2018, me objekt “*Rikonstruktion i pavionit dhe ndërtimi i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUT*”, me fond limit 56.125.510,83 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 08.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Në datën 08.10.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 18.10.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Inerti” sh.p.k.	46.873.738 lekë, kualifikuar
2. BOE “Euro-Alb Konstruksion” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k.	48.821.515,14 lekë, kualifikuar
3. “4 A-M” sh.p.k.	55.735.195 lekë, kualifikuar
4. BOE “Gjikuria” sh.p.k. & “Ante” sh.p.k.	55.844.303,33 lekë, kualifikuar
5. “Shansi Invest” sh.p.k.	56.121.426 lekë, skualifikuar
6. “ED Konstruksion” sh.p.k.	56.123.493,77 lekë, skualifikuar
7. “Biba X” sh.p.k.	56.123.523 lekë, skualifikuar
8. “Elda - VL” sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
9. “ADR Trans” sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb Konstruksion” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k. në datën 25.10.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k. me pretendimet si më poshtë vijon:

[...] Ne lidhje me kualifikimin e ofertave paraqesim kundërshtimet tona, pasi KVO me dashje ka shkelur LPP duke kryer hapur diskriminim dhe konsumuar vepren penale të shkeljes së barazisë në tendera pasi ka kualifikuar shoqerine “Inerti” sh.p.k. pavarësisht se ka konstatuar që ka mangësi dhe parregullsi të theksuara në dokumentat që ka paraqitur për kualifikim. Për të ardhur në ndihmë AK dhe Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, po ju veme në dijeni për mungesat që “Inerti” sh.p.k. ka në dokumentat e tenderit. Një pjesë të tyre AK i ka konstatuar dhe me pare nepermjet KVO pasi figurojnë në sistemin. Mangësitë dhe parregullsitë në dokumentacionin e paraqitur nga “Inerti” sh.p.k. janë:

1. Njeri nga drejtuesit teknik, Kreshnik Boci nuk figuron në listepagese për muajt maj-qershor korrik-gusht 2018. Kjo në kundërshtim me VKM nr.42, datë 16.01.2008 për drejtuesit teknike.. Nese ky drejtues teknik eshte larguar i bie qe “Inerti” shpk qe nga kjo periudhe eshte pa License.

Cdo drejtues teknik qe figuron ne license ne baze te ligjit duhet te figuroje ne listepagesa.

2. Mungon nje punonjes i certifikuar per punime ne lartesi. AK ka kerkuar 4 te tille. "Inerti" shpk ka paraqitur 3.

3. Mungon teknik elektrikist me deftese sic kerkohet ne dokumentat e tenderit.

4. Mungon teknik ndertimi me deftese sic kerkohet ne dokumentat e tenderit.

5. Mungon teknik mekanik me deftese sic kerkohet ne dokumentat e tenderit

6. Mungojne dy punonjes karpentiere sic kerkohet ne dokumentat e tenderit

7. Mungojne dy punonjes hekurkthyes sic kerkohet ne dokumentat e tenderit.

8. Ne kapacitetin teknik mungojne dy kamioncina sic kerkohet ne dokumentat e tenderit.

Persa i perket kerkeses se AK per te paraqitur Autorizime Prodhuesi, "Inerti" shpk nuk ka paraqitur asnje te tille ne perputhje me kerkesat e AK dhe Udhezimit te APP-se date 03.09.2018, Nr 8197 Prot ku thuhet se Certifikatat me standartet e viteve 2008 dhe 2004 jane te vlefshme deri ne shtator 2018. Pas ketij afati pranohen vetem statndartet e perditesuara ISO 9001-2015.

Me konkretisht:

- "Inerti" sh.p.k. nuk ka Autorizim Prodhuesi te rregullt per pajisje hidraulike, hidrosanitare dhe shtresash sipas kerkesave te AK dhe DST.
- "Inerti" sh.p.k. nuk ka Autorizim Prodhuesi te rregullt per pajisje elektrik dhe ndricimi sipas kerkesave te AK dhe DST
- "Inerti" sh.p.k. nuk ka Autorizim Prodhuesi per pajisje kondicionimi dhe ngrohje
- "InertiI" sh.p.k. nuk ka Autorizim Prodhuesi per pajisje telefonie, IT dhe kamera.
- "Inerti" sh.p.k. nuk ka Autorizim Prodhuesi per dyer.
- "Inerti" sh.p.k. nuk ka Autorizim Prodhuesi te rregullt per bojera, materiale hidroizolim, hekur dhe inerte.
- "Inerti" sh.p.k. nuk ka Autorizim Prodhuesi per pajisje MNZ

Dokumentat e paraqitura nuk jane te perkthyer ne shqip ashtu sic kerkohet ne DST.

Per sa me siper kualifikimi i kesaj kompanie me gjithë keto mungesa perben shkelje te rendesishme te ligjit me qellime korruptive

Ne kerkojme nga Autoriteti Kontraktor qe nepermjet Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave, te skualifikojë "Inerti" sh.p.k. dhe te shpalle oferten tone fituese duke qene se ploteson 100 % te gjitha kerkesat e AK.

II.4.1. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 29.10.2018, me anë të shkresës nr.2304/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues duke e refuzuar ankesën e tyre. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

"[...] Ne vleresimin e KVO ka patur dhe kundërshtim për kualifikimin e ofertave dhe një nga pesë anëtarët ka vlerësuar se asnjë nga ofertat e paraqitura nuk kualifikohet dhe kete e ka paraqitur ne sistemin elektronik per dijeni te gjithë pjesmarresve ne procedure. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave ne bashkpunim me KVO sqaron arsyet e kualifikimit te ofertave te OE te renditur ne kater vendet e para dhe shpalljen fitues te "Inerti" shpk sipas kriterit te vleresimit te fituesit me oferten ekonomike me te ulet dhe qe permbush kerkesat e AK te cilat jane ne proporcion me zerat e punimeve qe do te realizohen. OE "Inerti" sh.p.k. ka paraqitur dokumentacion te rregullt per Kriteret e Përgjithshme dhe per Kriteret e Vecanta duke permbushur kerkesat e AK.

BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk pershkruajne mangesite e OE "Inerti" shpk te siper permendura si arsye te forta per skualifikimin e ofertes se ketij operatori. Per sa me siper, KSHA ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga OE "Inerti" shpk duke sqaruar si me poshte:

a) Persa i perket drejtuesit teknik, Kreshnik Boci, i cili permendet ne piken e pare te ankeses ju sqarojme se OE "Inerti" shpk i ka permbushur kerkesat e AK duke i paraqitur te gjithë drejtuesit teknik te kerkuar ne kriteret teknike. Ky OE ka paraqitur dokumentacion per Inxhinier elektrik dhe elektronik punonjesit Arben Rrapo dhe Abdullah Elezi. Pretendimet e BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk nuk kane te bejne me kerkesat e AK pasi dokumentat e paraqitura per drejtuesit teknik dhe licencat jane te rregullta dhe konform kerkesave tona. Si konkluzion, ankesa e BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk nuk qendron ne lidhje me kete pike.

b) Persa i perket "kamionave" te tonazheve 1 deri ne 3 Ton te cilat pretendohet se nuk i disponon OE i renditur ne vend te pare sqarojme se AK ka kerkuar qe OE te paraqesin dokumentacion per 6 kamiona me tonazh 1 deri 3 Ton (2 cope), 3 deri ne 5 Ton (2 cope) kamiona per transport mbi 10 Ton (2 cope). Per sa me siper OE "Inerti" shpk ka paraqitur kontrata qiraje per rreth 16 Kamiona te ndryshem dhe ka paraqitur dokumentacion te rregullt per 8 Kamiona te tonazheve ndryshem. Ne dokumentacion rezultojne dhe 2 kamiona me targa "AA260GC" dhe "TR1231 P", te cilet rezultojne te jene kamiona per tonazh deri ne tre Ton. Kamioni me targe AA260GC rezulton, sipas librezes se qarkullimit, te jete ne gjendje te trasportoje nje maksimale deri ne 2945 kg. Kamioni me targe "TR1231P" rezulton, sipa librezës së qarkullimit, te jete ne gjendje te trasportoje nje sasi maksimale deri ne 2610 kg. Sipas ketyre te dhenave rezulton se ky operator i permbush kerkesat e AK dhe i disponon makinerite e kerkuara. Anetarja e KVO e cila ka vleresuar mangesine e ketyre dy kamioncinave ka bere nje gabim njerezor duke pare tonazhin e makinerive ne certifikate e kontrollit teknik dhe jo ne Lejen e qarkullimit ku duhej te bazohej per vleresim. Si konkluzion, ankesa e BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk nuk qendron ne lidhje me kete pike.

c) Persa i perket mangesive te teknikeve: teknik elektrikist, teknik ndertimi, dhe teknik mekanik ju sqarojme se te gjithë keta teknik jane ne dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik i renditur ne vend te pare "Inerti" shpk. Ky OE ka paraqitur dokumentacion per tekniket si me poshte: 4 elektrikiste (E. Bardhi, E. Bregasi, A. Capun, N. Stafaj) me kontrate te rregullt pune, CV dhe Deshmi Kualifikimi perkatese. 2 Teknike ndertimi (J. Vrapit, B. Hereni) me kontrate te rregullt pune, CV dhe Deshmi Kualifikimi perkatese. 2 Teknike Mekanike (A. Husha, Xh. Ziko) me kontrate te rregullt pune, CV dhe Deshmi Kualifikimi perkatese. Si konkluzion, ankesa e BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk nuk qendron ne lidhje me kete pike. Fakti qe jane kerkuar deftesat per te vertetuar kualifikimin e ketyre teknikeve nuk e perjashton faktin se "Deshmte e kualifikimit" nuk jane dokumenta te rregullta apo qe vene ne dyshim aftesine teknike te ketyre punonjesve. Per me teper ky OE ka paraqitur Inxhinier elektrikist si drejtues teknik te shoqerise.

d) Persa i perket mangesive te teknikeve: karpentiere dhe hekurthyes ju sqarojmë si me poshte: Operatori ekonomik i renditur ne vend te pare "Inerti" shpk ka paraqitur fuqi punetore dyfish me te larte se ajo e kerkuar ne dokumentat e tenderit. Nga verifikimet e kryera ne listpagesat e shoqerise rezulton se ky operator ka ne listpagesa te pakten 7 punonjes me kodin 9313.01, sipas verifikimeve te kryera nga KSHA rezulton se keta punonjes mund te kryejne lehtesisht profesionin e karpentierit dhe ate te hekurthyesit. Per me teper ne dokumentat e paraqitura rezultojne 2 teknik ndertimi (nga 1 te kerkuar) te cilet mund te kryejne edhe punimet qe kryen karpentieri si dhe 2

saldatore (nga 1 te kerkuar) te cilet mund te kryejne punimet si hekurthyes. Kujtojme qe punimet qe do te kryhen, sipas zerave te preventivit, nga karpentiere dhe hekurthyes jane minimaliste pasi kemi te bejme me rikostruksion dhe jo ndertim nga e para te godines. Kriteret e vendosura jane kusht skualifikimi ne momentin qe keto kriteret jane proporcion me objektin e kontrates dhe ne kete rast kemi te bejme me nje nga shume pikat e kerkuara ne nje kriter te vetem kualifikimi. Ky OE ka vertetuar plotesisht, me ane te dokumentave, qe e ploteson kriterin e fuqise punetore te kerkuar nga ana e AK. Si konkluzion, ankesa e BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk nuk qendron ne lidhje me kete pike.

e) Ne lidhje me piken e fundit te ankeses ku pretendohet se operatori ekonomik i renditur ne vend te pare "Inerti" shpk nuk ka paraqitur ISO prodhuesi apo qe keto ISO jane ne kundershtim me Udhezimin e APP-se Nr. 8197 Dt.03.09.2018 pasi ISO 9001:2008 eshte e vlefshme deri ne shtator 2018. Ju bejme me dije se AK ka hedhur ne sistemin elektronik procedure e prokurimit perpara se te publikohej Udhezimi i APP-se Nr. 8197 Dt. 03.09.2018 (procedura eshte hedhur ne sistem ne daten 31.08.2018). Megjithate, KVO ne bashkepunim me Njesine e Prokurimit ne SUT kane vendosur qe te mos marin parasysh asnje ISO prodhuesi pasi eshte ne kundershtim me Udhezimin e sipercituar. Edhe certifikatat qe kane qene te vlefshme ne daten e publikimit te tenderit nuk mund te quhen te pavlefshme nga ana e AK pasi ato mund te rinovohen ne cdo moment.

Persa i perket "Autorizimeve te prodhuesit", KSHA verifikoi se OE "Inerti" shpk ka paraqitur te gjitha autorizimet e Prodhuesit ose te distributorit te autorizuar prej tij dhe nuk ka asnje mangesi ne dokumentacion ashtu sic pretendon BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk. Si konkluzion, ankesa e BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk nuk qendron ne lidhje me kete pike. Duke perfunduar arsvetimin tone, ju njoftojme se vendosia e kriterëve nga ana e AK eshte te vertetoje qe nje OE pjesmarres te iete ne giendje te realizoje kontraten. Ne asnje rast AK nuk kerkon arsye skualifikimi duke gjetur mangesi (devijime te vogla) ne dokumentacionin e operatoreve. Ju bejme me dije se te kater OE te kualifikuar ne kete procedure kane patur mangesi/devijime te vogla si keto te permendura ne kete ankese por qe nuk mund te quhen kurr sesi arsye te forta skualifikimi. KSHA duke u nisur nga LPP, VKM 914 e ndryshuar dhe udhezimet perkatese arsveton se OE i renditur ne vend te pare "Inerti" shpk, eshte ne gjendje te realizoje kontraten dhe i ploteson te gjitha kushtet e kualifikimit duke qene dhe operatori me cmimin me te ulet te ofruar (cmimi me i ulet eshte kushti krvesor ne kualifikimin e OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi). Per me teper ju sqarojme se KVO ka vleresuar me objektivitete dhe eshte e qarte qe Ak ka si objektiv realizimin sa me shpejt te kesaj procedure prokurimi dhe vonesa e lidhjes se kesaj kontrate apo mos kryerja e punimeve ne kohe do te sjelle nje mangesi te theksuar ne sherbimin qe ofron SUT. Vendimet tona dhe te KvO jane ne perputhje te plote me rekomandimet e KLSH dhe grupeve te auditit te cilet e kane perseritur ne menyre te vazhdueshme faktin se cmimi me i ulet i ofruar eshte kushti kryesor i kualifikimit te OE ne menyre qe te mos behet dem ekonomik ne Buxhetin e Shtetit. Si perfundim, u vleresua qe ankesa juaj te mos merret parasysh.

II.4.2. Në datën 31.10.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb Konstruktion” sh.p.k. & “Viante Konstruktion” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën pranë autoritetit kontraktor. Gjithashtu në ankësën pranë KPP, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka shtuar:

[...] ...Një pjesë e këtyre dokumentave është e fallsifikuar. Kjo gjë provohet lehtë, por nga ana e AK është anashkaluar me qëllim sepse “Inerti” sh.p.k. ka ngarkuar në system si ISOT origjinale ashtu dhe të fallsifikuara. Bashëngjitur ju dërgojmë dokumentat të cilat janë fallsifikuar si dhe origjinalet.

- ISO Everest e fallsifikuar
- ISO Euro-Bicaku e fallsifikuar
- Autorizim Ilira Plast i modifikuar
- ISO DeutchColor e fallsifikuar
- ISO Midea e fallsifikuar
- ISO Klimateknika e fallsifikuar

Sipas LPP fallsifikimi i dokumentave zyrtare për arsye kualifikimi përbën vepër penale. Autoriteti kontraktor duhet të kishte zbatuar ligjin duke kryer veprimet e nevojshme që kërkohen në këto raste. [...]

II.5. Operatori ekonomik “4 A-M” sh.p.k. në datën 25.10.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k. dhe kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Euro-Alb Konstruksion” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k. me pretendimet si më poshtë vijon:

[...]

“Pasi u njohem me klasifikimin e Autoritetit Kontraktor, referuar edhe kërkesave të procedurës së mesiperme kemi pretendime lidhur me kualifikimin e ofertes së shoqërisë “Inerti” sh.p.k. dhe shoqërisë “Euro-Alb” sh.p.k. Referuar shoqërisë “Inerti” shpk në klasifikimin e procedurës jemi njohur edhe me disa nga arsyetimet e mospermbyshjes së kriterëve për kualifikim. Në vlerësimin e Autoritetit thuhet shprehimisht “Inerti” ka 3 të punësuar me kontratë pune dhe certifikatë për punime në lartësi ndërkohë që duhen 4. Nuk ka deftesë për teknik elektrikist dhe teknik ndërtimi, nuk ka karpentierë, hekurkthyes, teknik mekanik, nuk ka kamioncine 1-3 ton Nuk ka asnjë dokument. Arsyet e mesiperme të shkruara nga AK, për të cilat jemi njohur nepermjet mesazhit në sistem, tregojnë mungesë serioziteti në vlerësimin e ofertes së shoqërisë “Inerti” sh.p.k. nga KVO dhe kualifikimin pa të drejtë të këtij operatori. Duke parë këtë vlerësim mendojmë se shoqëria ka mungesë të mëdha në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar sipas kriterëve të vecanta për kualifikim. Si rrjedhojë oferta e shoqërisë “Inerti” shpk duhet të skualifikohet. Referuar shoqërisë “Euro-Alb” shpk në klasifikimin e procedurës jemi njohur edhe me arsyetimin e mospermbyshjes së kriterëve për kualifikim. Në të shprehet se nuk ka përfshirë fondin rezervë në oferte. Thëksojmë se oferta ekonomike duhet të plotësohet në mënyrë rigorozë dhe sipas formatit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor. Cdo ndryshim apo devijim nga modeli i preventivit të ngarkuar në sistem nga AK është arsye për skualifikim. Thëksojmë se mungesa e seriozitetit në vlerësim të AK verëhet edhe në vlerësimin e shoqërisë “Euro-Alb” sh.p.k. Kërkojmë rishikimin e ofertes së shoqërisë “Euro-Alb” sh.p.k. dhe skualifikimin e saj. Kërkesa jone i referohet parashikimeve ligjore në fushën e prokurimit publik e me konkretisht parashikohet pika 1, germa "b", të ligjit nr 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar [...]. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar parashikohet [...]. Nderkohë edhe pse shoqëria jone sipas klasifikimit të AK është e kualifikuar jemi njohur nepermjet sistemit me një pretendim ku shprehet se oferta ekonomike nuk është e sakte. Edhe pse ky pretendim nuk ka marrë mbështetjen e shumicës së KVO-se, mqs oferta rezultoi e kualifikuar duam të theksojmë se

preventive/oferta eshte perllogaritur sipas modelit te preventivit me cmime te publikuar ne APP, duke ndjekur te njejten logiike dhe te njejtat formula. Seksioni Makineri dhe pajisje jane vendosur me TVSH. Gjithcka eshte plotesuar ne perputhje me preventivin e ngarkuar ne sistem nga AK. Si përfundim kërkojmë marrjen parasysh të ankesës tonë dhe skualifikimine shoqerive "Inerti" dhe "Euro-Alb".

II.5.1. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 29.10.2018, me anë të shkresës nr.2299/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes duke e refuzuar ankesën e tyre. Ndërkohë, operatori ekonomik ankimes "4 A-M" sh.p.k., në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pretendon se nuk ka marrë dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor. Konkretisht, referuar shkresës së autoritetit kontraktor, ky i fundit ka argumentuar si më poshtë:

"[...]Ne vleresimin e KVO ka patur dhe kundërshtim për kualifikimin e ofertave dhe një nga pesë anëtarët ka vlerësuar se asnjë nga ofertat e paraqitura nuk kualifikohet dhe kete e ka paraqitur ne sistemin elektronik për dijeni të gjithë pjesëmarrësve në procedurë. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në bashkëpunim me KVO sqaron arsyet e kualifikimit të ofertave të OE të renditur në kater vendet e para dhe shpalljen fitues të "Inerti" shpk sipas kriterit të vleresimit të fituesit me ofertën ekonomike me të ulët dhe që përmbush kërkesat e AK të cilat janë në proporcion me zerat e punimeve që do të realizohen. OE "Inerti" shpk ka paraqitur dokumentacion të rregullt për Kriteret e Përgjithshme dhe për Kriteret e Vecanta duke përmbushur kërkesat e AK. OE "4 A-M shpk përshkruan mangesitë e OE "Inerti" shpk të siperpermendura si arsye të forta për skualifikimin e ofertes së këtij operatori. Për sa më sipër, KSHA ka rishikuar dokumentacionin e paraqitur nga OE "Inerti" shpk duke sqaruar si më poshtë:

a) Persa i përket "kamionave" të tonazheve 1 deri në 3 Ton të cilat pretendohet se nuk i disponon OE i renditur në vend të parë sqarojmë se AK ka kërkuar që OE të paraqesin dokumentacion për 6 kamiona me tonazh 1 deri 3 Ton (2 cope), 3 deri në 5 Ton (2 cope) kamiona për transport mbi 10 Ton (2 cope). Për sa më sipër OE "Inerti" shpk ka paraqitur kontratë qiraje për rreth 16 Kamiona të ndryshëm dhe ka paraqitur dokumentacion të rregullt për 8 Kamiona të tonazheve ndryshëm. Në dokumentacion rezultojnë dhe 2 kamiona me targa "AA260GC" dhe "TR1231 P", të cilët rezultojnë të jenë kamiona për tonazh deri në tre Ton. Kamioni me targe AA260GC rezulton, sipas librezës së qarkullimit, të jetë në gjendje të transportojë një maksimale deri në 2945 kg. Kamioni me targe "TR1231P" rezulton, sipa librezës së qarkullimit, të jetë në gjendje të transportojë një sasi maksimale deri në 2610 kg. Sipas ketyre të dhënave rezulton se ky operator i përmbush kërkesat e AK dhe i disponon makineritë e kërkuara. Anëtarja e KVO e cila ka vlerësuar mangesinë e ketyre dy kamioncinave ka bërë një gabim njëzëror duke parë tonazhin e makinerive në certifikatë e kontrollit teknik dhe jo në Lejen e qarkullimit ku duhet të bazohet për vlerësim. Si konkluzion, ankesa e OE "4AM" shpk nuk qëndron në lidhje me këtë pikë.

b) Persa i përket mangesive të teknikeve: teknik elektrikist, teknik ndertimi, dhe teknik mekanik ju sqarojmë se të gjithë këta teknik janë në dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik i renditur në vend të parë "Inerti" shpk. Ky OE ka paraqitur dokumentacion për teknikat si më poshtë: 4 elektrikiste (E. Bardhi, E. Bregasi, A. Capun, N. Stafaj) me kontratë të rregullt pune, CV dhe Dëshmi Kualifikimi perkatese. 2 Teknike ndertimi (J. Vrapit, B. Hereni) me kontratë të rregullt pune, CV dhe Dëshmi Kualifikimi perkatese. 2 Teknike Mekanike (A. Husha, Xh. Ziko) me kontratë të rregullt pune, CV dhe Dëshmi Kualifikimi perkatese. Si konkluzion, ankesa e OE

"4AM" shpk nuk qendron ne lidhje me kete pike. Fakti qe jane kerkuar deftesat per te vertetuar kualifikimin e ketyre teknikeve nuk e perjashton faktin se "Deshmite e kualifikimit" nuk jane dokumenta te rregullta apo qe vene ne dyshim aftesine teknike te ketyre punonjesve. Per me teper ky OE ka paraqitur Inxhinier elektrikist si drejtues teknik te shoqerise.

c) Persa i perket mangesive te teknikeve: karpentiere dhe hekurthyes ju sqarojmë si me poshte: Operatori ekonomik i renditur ne vend te pare "Inerti" shpk ka paraqitur fuqi punetore dyfish me te larte se ajo e kerkuar ne dokumentat e tenderit. Nga verifikimet e kryera ne listpagesat e shoqerise rezulton se ky operator ka ne listepagesa te pakten 7 punonjes me kodin 9313.01, sipas verifikimeve te kryera nga KSHA rezulton se keta punonjes mund te kryejne lehtesisht profesionin e karpentierit dhe ate te hekurthyesit. Per me teper ne dokumentat e paraqitura rezultojne 2 teknik ndertimi (nga 1 te kerkuar) te cilet mund te kryejne edhe punimet qe kryen karpentieri si dhe 2 saldatore (nga 1 te kerkuar) te cilet mund te kryejne punimet si hekurthyes. Kujtojmë qe punimet qe do te kryhen, sipas zerave te preventivit, nga karpentiere dhe hekurthyes jane minimaliste pasi kemi te bejme me rikostruksion dhe jo ndertim nga e para te godines. Kriteret e vendosura jane kusht skualifikimi ne momentin qe keto kritere jane proporcion me objektin e kontrates dhe ne kete rast kemi te bejme me nje nga shume pikat e kerkuara ne nje kriter te vetem kualifikimi. Ky OE ka vertetuar plotesisht, me ane te dokumentave, qe e ploteson kriterin e fuqise punetore te kerkuar nga ana e AK. Si konkluzion, ankesa e OE "4AM" shpk nuk qendron ne lidhje me kete pike.

Duke perfunduar arsvetimin tone, ju njoftojme se vendosja e kriterëve nga ana e AK eshte te vertetoje qe nje OE pjesmarres te jete ne gjendje te realizoje kontraten. Ne asnje rast AK nuk kerkon arsye skualifikimi duke gjetur mangesi (devijime te vogla) ne dokumentacionin e operatoreve. Ju bejme me dije se te kater OE te kualifikuar ne kete procedure kane patur mangesi/devijime te vogla si keto te permendura ne kete ankese por që nuk mund te quhen kurrsesi arsye te forta skualifikimi. KSHA duke u nisur nga LPP, VKM 914 e ndryshuar dhe udhezimet perkatese te APP arsyeton se OE i renditur ne vend te pare "Inerti" shpk, eshte ne gjendje te realizoje kontraten dhe i ploteson te gjitha kushtet e kualifikimit duke qene dhe operatori me cmimin me te ulet te ofruar (cmimi me i ulet eshte kushti krvesor ne kualifikimin e OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi).

2. Ne lidhje me kualifikimin e ofertes se BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk ju sqarojmë se: Eshte e vertete qe ky OE nuk ka parashikuar zerin e punimeve "fondin reserve ne masen 5%" ne oferten e tij dhe qe kjo eshte nje mangesi. KSHA duke u konsultuar me KVO ka verifikuar kerkesat e AK ne DST dhe rezulton se ne preventivin pa cmime kjo gje nuk eshte kerkuar qartazi por eshte perlllogaritur strukturen e preventivit duke nxjerre dhe vleren totale me Tvsh. Njesia e prokurimit ka ngarkuar ne sistemin elektronik dhe preventivin me cmime per ta patur si model OE pjesmarres ne tender. OE i renditur ne vend te dyte, ne perlllogaritjen e ofertes se tij ka marre parasysh preventivin pa cmime dhe nuk e ka perlllogaritur fondin rezerve 5%. Nisur nga keto, KSHA arsyeton se fondi rezerve, nuk eshte kerkuar qartazi ne dst dhe kjo ka krijuar konfuzion ne OE pjesëmarrës. Per me teper mendojmë se kjo pike mund te sqarohet në kontraten qe do te lidhet mes paleve ne rast se BOE "Euro-Alb" shpk & "Viante Konstruktion" shpk do te shpallej fitues. Per keto arsye propozojmë qe dhe kjo pike e ankeses se OE "4 A-M" shpk, te mos merret parasysh.

Per me teper ju sqarojmë se KVO ka vleresuar me objektivitete dhe eshte e qarte qe Ak ka si objektiv realizimin sa me shpejt te kesaj procedure prokurimi dhe vonesa e lidhjes se kesaj kontrate apo

mos kryerja e punimeve ne kohe do te sjelle nje mangesi te theksuar ne sherbimin qe ofron SUT. Vendimet tona dhe te KVO jane ne perputhje te plote me rekomandimet e KLSH dhe grupeve te auditit te cilet e kane perseritur ne menyre te vazhdueshme faktin se cmimi me i ulet i ofruar eshte kushti kryesor i kualifikimit te OE ne menyre qe te mos behet dem ekonomik ne Buxhetin e Shtetit. Si perfundim, u vleresua qe ankesa juaj te mos merret parasysh.”

II.5.2. Në datën 05.11.2018 operatori ekonomië “4 A-M” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 2414/1 prot., datë 07.11.2018, protokolluar me tonën në datën 09.11.2018, me objekt “Informacion”, shkresës nr. 2414/2 prot., datë 07.11.2018, protokolluar me tonën në datën 09.11.2018, me objekt “Kthim përgjigje mbi vlerësimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-84317-08-31-2018, me objekt “Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtimi i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUT”, me fond limit 56.125.510,83 lekë (pa TVSH), vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit” dhe shkresës nr. 2467/2 prot., datë 16.11.2018, protokolluar me tonën në datën 19.11.2018, me objekt “Informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.



pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Euro-Alb Konstruksion” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k. me pretendimin se “...Mungojne dy punonjes karpentiere dhe dy punonjes hekurkthyes sic kerkohet ne dokumentat e tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.11/b e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“Ofertuesi duhet të ketë të punësuar si dhe të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë për 6 muajt e fundit të vitit 2018, punonjësit si më poshtë:

“2.3.11 b)

- Hidroizolues shoqëruar me kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI, minimalisht 3 të punësuar.

- *Bojaxhi shoqëruar me kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI, minimalisht 2 të punësuar.*
- *Pllakashtrues shoqëruar me kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI, minimalisht 3 të punësuar.*
- *Karpentier shoqëruar me kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI, minimalisht 2 të punësuar.*
- *Hekurkthyes shoqëruar me kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI, minimalisht 2 të punësuar.*
- *Mekanik shoqëruar me kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI, minimalisht 1 të punësuar.*
- *Teknik mekanik shoqëruar me deftese, kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI, minimalisht 1 të punësuar.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Inerti” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për këta punonjës dhe konkretisht, kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*”

III.1.4. Në nenin 26, pika 8/b të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.5. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*”.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e

veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të kenë të punësuar në staf si dhe të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë për 6 muajt e fundit të vitit 2018, minimalisht 2 punonjës karpentier dhe minimalisht 2 punonjës hekurkthyes, të cilët duhet të jenë të pajisur me kontratë pune dhe dëshmi kualifikimi e sigurimi teknik nga ISHTI. Nisur nga pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues, KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik "Inerti" sh.p.k., konstaton se ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion me anë të të cilit të provojë se ka të punësuar dy punonjës me profesion karpentier dhe dy punonjës me profesion hekurkthyes. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

III.1.9. Akoma më tej, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, në lidhje me pretendimin e mësipërm ka argumentuar "*Persa i perket mangesive te teknikeve: karpentiere dhe hekurthyes ju sqarojmë si me poshte: Operatori ekonomik i renditur ne vend te pare "Inerti" shpk ka paraqitur fuqi punetore dyfish me te larte se ajo e kerkuar ne dokumentat e tenderit. Nga verifikimet e kryera ne listpagesat e shoqerise rezulton se ky operator ka ne listepagesa te pakten 7 punonjes me kodin 9313.01, sipas verifikimeve te kryera nga KSHA rezulton se keta punonjes mund te kryejne lehtesisht profesionin e karpentierit dhe ate te hekurthyesit. Per me teper ne dokumentat e paraqitura rezultojne 2 teknik ndertimi (nga 1 te kerkuar) te cilet mund te kryejne edhe punimet qe kryen karpentieri si dhe 2 saldatore (nga 1 te kerkuar) te cilet mund te kryejne punimet si hekurthyes. Kujtojmë qe punimet qe do te kryhen, sipas zerave te preventivit, nga karpentiere dhe hekurthyes jane minimaliste pasi kemi te bejme me rikostruksion dhe jo ndertim nga e para te godines.*" Pra sa më sipër, vetë autoriteti kontraktor ka pranuar në mënyrë të shprehur, se operatori ekonomik "Inerti" sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në dokumentat e tenderit (kontratë pune dhe dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik), për punonjësit e kërkuar si karpentier dhe hekurkthyes, por e argumenton këtë mungesë me faktin që ky funksion mund të kryhet nga teknikët e ndërtimit dhe saldatori.

Për më tepër, referuar arsytimit të autoritetit kontraktor, lidhur me kodin 9313.01, nga verifikimi në VKM Nr.627, datë 11.6.2009 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve", i ndryshuar,

konstatohet se kodi i cituar nga autoriteti kontraktor 9313.01, nuk i përket profesionit të karpentierit apo hekurkthyesit.

III.1.10. Sa më sipër, nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, në asnjë moment nuk vërtetohet dhe nuk dokumentohet fakti se shoqëria “Inerti” sh.p.k. ka të punësuar dy punonjës si karpentier dhe dy punonjës hekurkthyes. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartësisht në dokumentat e tenderit, se cilat dokumenta duhen paraqitur me qëllim vërtetimin e një fakti të tillë. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive, pasi ka mungesë fizike të dokumentacionit kontratë pune dhe dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI, kërkesa këto të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.11. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP.

Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

III.1.12. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Rrjedhimisht, pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k. dhe operatorit ekonomik “4 A-M” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k. qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k. dhe operatori ekonomik “4 A-M” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik,

gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që iu është pranuar një nga pretendimet e tyre dhe gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k. do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përbushur interesin e ankimuesve, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “4 A-M” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k. me argumentin se “Nuk ka përfshirë fondin rezervë në ofertë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës” pika 1.1. përcaktohet: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.”

Ndërsa në pikën 1.6. përcaktohet: *Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:*

a) *Formularin e Ofertës (Preventivi), plotësuar sipas Shtojcës 1.*

b) *Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (skica, projekte, etj)*

_____ ,

_____ ,

_____ .

c) *Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 12.*

ç) *(opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)*

III.3.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 1 “Formulari i ofertës ekonomike”, është përcaktuar kriteri: Shtojca 1

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;

2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						

3.						
<i>Shuma</i>						
<i>Fondi Rezervë</i>						
<i>Shuma</i>						
<i>TVSH</i>						
<i>SHUMA TOTAL</i>						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.3.3. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 14 “Preventivat e Punimeve”, është përcaktuar kriteri:

Preventivat e punimeve do të jene pjese e kesaj DST-je dhe do te bashkangjiten ne format Pdf.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, bashkëlidhur dokumentave të tenderit edhe dokumentacionin si më poshtë:

- Preventiv zbatimi pa cmimi
- Preventiv zbatimi me cmime
- Preventiv përmbledhës si më poshtë:

I	EMERYTIMI I PUNIMEVE	Vlera
A	PUNIME NDERTIMI	24764573.2
B	INSTALIME ELEKTRIKE	9853944.2
C	INSTALIME HIDRONIKE	15,865,153
	Shuma	50,483,670
	Fondi rezerve 5%	2,524,184
	Shuma	53,007,854
	TVSH ja 20 %	10,601,571
	Shuma I	63,609,425
II	PAISJE DHE MAKINERI	3,741,188
	Shuma II	3,741,188
	TOTALI (I+II)	67,350,613

III.3.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (S.P.E) nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. & “Viante Konstruktion” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. *Formulari i ofertës ekonomike*
2. *Preventiv përmbledhës*
3. *Preventiv zbatimi*

III.3.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në

procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.3.6. Në nenin 26 pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: ” Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projekt mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.

Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale). ”

III.3.7. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.8. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në pjesën “Udhëzime për operatorët ekonomikë” përcaktohet “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme “. Gjithashtu autoriteti kontraktor në këto dokumenta ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas tabelës në Shtojcën 1 ku në këtë tabelë kërkohet të paraqitet Përshkrimi i punëve, njësia, sasia, cmimi/njësi, cmimi total, Shuma totale pa tvsh, Fondi rezervë, Tvsh, Shuma totale me tvsh. Bazuar në shtojcën 14 “Preventivat e Punimeve” autoriteti kontraktor ka publikuar një preventiv zbatimi të të gjithë zërave të punimeve që kërkohet të realizohen, pa çmime dhe një preventiv zbatimi të të gjithë zërave të punimeve që kërkohet të realizohen shoqëruar me çmime. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka publikuar edhe një preventiv përmbledhës ku përfshihen “Emërtimi I Punimeve”, “Fondi rezervë”, “Tvsh”, “Paisje dhe Makineri” dhe “Shuma Totale”. Pra, autoriteti kontraktor si në formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 të dokumentave të tenderit, edhe në preventivin përmbledhës, bashkëlidhur dokumentave të tenderit sipas shtojcës 14, ka kërkuar që në ofertën e tyre operatorët ekonomikë të përfshijnë edhe fondin rezervë. Sa më sipër, nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. dhe “Viante Konstruksion” sh.p.k., KPP konstaton se, ky i fundit ka paraqitur formularin e ofertës (shtojca 1) duke përfshirë vetëm shumën totale pa dhe me TVSH dhe nuk ka përcaktuar fondin rezervë, sic kërkohet në dokumentat e tenderit. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. dhe “Viante Konstruksion” sh.p.k. edhe në preventivin përmbledhës, nuk ka parashikuar zërin për fondin rezervë të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, KPP sqaron se, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, ndaj dhe të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me këto dokumenta. Theksojmë se, përsa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar dhe përcaktuar shprehimisht në formularin e ofertës edhe llogaritjen e zërit për fondin rezervë, atëherë, në këtë rast, operatori ekonomik duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin në përputhje me këtë përcaktim, pasi fondi rezervë është një element i rëndësishëm i preventivit të punimeve për procedurën objekt shqyrtimi, përvec faktit që është një element i detyrueshëm i përcaktuar në DST nga autoriteti kontraktor, mungesa e të cilit ndikon në përllogaritjen e vlerës totale të ofertës. Gjithashtu, mungesa e përllogaritjes së fondit rezervë në vlerën totale të ofertës, rrjedhimisht ndikon edhe në vlerësimin dhe renditjen e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, KPP konstaton se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga "Euro-Alb" sh.p.k. dhe "Viante Konstruksion" sh.p.k. nuk përmbush kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit, ndaj do të konsiderohet e pavlefshme.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "4 A-M" sh.p.k. qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Euro-Alb" sh.p.k. dhe "Viante Konstruksion" sh.p.k. për procedurën e prokurimit "*Procedurë e hapur*", me nr. REF-84317-08-31-2018, me objekt "*Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtimi i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUT*", me fond limit 56.125.510,83 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 08.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "4 A-M" sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik "Inerti" sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë "Euro-Alb" sh.p.k. dhe "Viante Konstruksion" sh.p.k., duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë nga procedura e mësipërme e prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "4 A-M" sh.p.k.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1667 Protokolli
Datë 31.10.2018

Nr. 1685 Protokolli
Datë 05.11.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha



MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtares së Komisionit të Prokurimit Publik znj. Vilma Zhupaj (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtare e KPP shpreh mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, përse i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “4 A-M” sh.p.k., konkretisht nuk jam dakord me arsyetimin në pikën III.3. e në vijim, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-84317-08-31-2018, me objekt “*Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtimi i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUT*”, me fond limit 56.125.510,83 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 08.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “4 A-M” sh.p.k., për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” sh.p.k. me argumentin se “*Nuk ka përfshirë fondin rezervë në ofertë*”, vërej se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 1 “Formulari i ofertës ekonomike”, është përcaktuar kriteri:
Shtojca 1

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

3. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;

4. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën _____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 14 “Preventivat e Punimeve”, është përcaktuar kriteri: *Preventivat e punimeve do të jene pjese e kesaj DST-je dhe do te bashkangjiten ne format Pdf.* Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, bashkëlidhur dokumentave të tenderit edhe dokumentacionin si më poshtë:

- Preventiv zbatimi pa cmimi (në zëra nuk është paraqitur fondi rezervë)
- Preventiv zbatimi me cmime (në zëra nuk është paraqitur fondi rezervë)
- Preventiv përmbledhës (është paraqitur fondi rezervë)

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (S.P.E) nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. & “Viante Konstruktion” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

4. Formulari i ofertës ekonomike
5. Preventiv përmbledhës
6. Preventiv zbatimi

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.5. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor në formularin e ofertës (Shtojca 1) ka parashikuar Fondin Rezervë, por nuk ka parashikuar përqindjen apo vlerën që duhet të përlogaritet ky fond. Gjithashtu, autoriteti kontraktor, bashkëlidhur dokumentave të tenderit, ka publikuar një preventiv zbatimi pa çmime dhe një preventiv zbatimi me çmime. Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave, vërejt se autoriteti kontraktor nuk e ka kërkuar qartë në të gjitha dokumentat e tenderit të publikuara zërin për fondin rezervë, pasi në formularin e ofertës (shtojca 1) e ka parashikuar si zë, por pa përcaktuar vlerën, në shtojcën Preventiv pa çmime dhe në shtojcën Preventiv me çmime, në përmbledhësen e secilës prej këtyre dy dokumentave nuk është parashikuar zëri "Fondi rezervë", ndërkohë që në shtojcën Preventiv përmbledhës me çmime është parashikuar "Fondi Rezervë" në vlerën 5 %.

Sa më sipër argumentuar, gjykoj se autoriteti kontraktor në lidhje me kërkesën për fondin rezervë ka krijuar paqartësi dhe konfuzion tek operatorët ekonomikë pjesëmarrës, rrjedhimisht për shkak të këtij konfuzioni, bashkimi i operatorëve ekonomikë "Euro-Alb" sh.p.k. & "Viante Konstruksion" sh.p.k. kanë paraqitur preventivin e punimeve, pa përfshirë fondin rezervë.

III.1.7. Akoma më tej, gjykoj se autoriteti kontraktor, në dokumentat e tenderit ka publikuar shtojcën "Preventiv me çmime", duke paraqitur çmimet për të gjitha zërat e këtij preventivi si dhe vlerën totale.

I	EMERYTIMI I PUNIMEVE	Vlera
A	PUNIME NDERTIMI	24764573.2
B	INSTALIME ELEKTRIKE	9853944.2
C	INSTALIME HIDRONIKE	15,865,153
	Shuma	50,483,670
	Fondi rezerve 5%	2,524,184
	Shuma	53,007,854
	TVSH ja 20 %	10,601,571
	Shuma I	63,609,425
II	PAISJE DHE MAKINERI	3,741,188
	Shuma II	3,741,188
	TOTALI (I+II)	67,350,613

III.1.8 Në nenin 9 pika 1 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet: "Llogaritja e vlerës së kontratës":

1.Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit. Në llogaritjen e vlerës merret parasysh edhe

shuma totale që duhet paguar në rast ripërtëritjeje të kontratës, kur një rasti tillë është parashikuar. Kjo vlerë ka për qëllim klasifikimin e kontratës sipas kufijve monetarë dhe planifikimin e publikimin e procedurës së prokurimit. Vlera e TVSH-së llogaritet si zë më vete, por nuk përfshihet në vlerën limit të publikuar në njoftimin e kontratës. TVSH-ja, kur është e zbatueshme, i shtohet vlerës së ofertës fituese për llogaritjen e vlerës totale të kontratës që do të lidhet. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” :

1. Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret e ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jodiskriminuese . Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

III.1.9 Në këtë rast, autoriteti kontraktor, në kundërshtim me parimet dhe qëllimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konkretisht nenin 1 të tij, ka kufizuar konkurrencën e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi si dhe ka cënuar të drejtën e operatorëve ekonomikë për një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues. Rrjedhimisht, në shkelje të parimeve bazë të ligjit për prokurimin publik, gjykoj se autoriteti kontraktor duhet të anulojë këtë procedurë prokurimi.

III.1.10. Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;d) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”

III.1.11. Në nenin 30 “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, thuhet: “[...]Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë.

2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre [...]”.

III.1.12. Sipas nenit 31 pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: Ndalimin e autoritetit kontraktor të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor”, ndërsa në pikën 2 , gërma “a” thuhet se: “Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor

është në kundërshtim me ligjin 9643/2006 dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:

a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit [...]”.

III.1.13. Sa më sipër, gjykoj se për shkak të shkeljeve të mësipërme të konstatuara procedura e mësipërme e prokurimit duhet anuluar, në zbatim të nenit 64, pika 2 gërma “ç” dhe nenit 24 gërma “dh” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.

Përsa më sipër, gjykoj se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “4 A-M” sh.p.k. për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” sh.p.k. dhe “Viante Konstruksion” sh.p.k nuk qëndron, si dhe Autoriteti Kontraktor duhet të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.

